



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Nr 12 Prot.

Vlorë, më 11 . 09 . 2018

VENDIM

Nr. 7 _ Data 29.08.2018 _

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Zagorisë, dega e lumit Vjosë për ndërtimin e hidrocentralit "ZAGORI 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "ELECTRAL" sh.p.k., me administrator Z. Redi Frashëri.

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", formulari D, dokumentacioni teknik, Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta", Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit Ujor"; V.K.M Nr.822, datë 07.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", shkresës zyrtare të Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit, **Nr. 526, datë 21.10.2016 "Vënie në dijeni"**,

VENDOSI

Për shtyrjen e vendimit në mbledhjen e rradhës të kërkesës, për shfrytëzim të burimit ujor në lumin e Zagorisë, dega e lumit Vjosë për ndërtimin e hidrocentralit "ZAGORI 2" për prodhim të energjisë elektrike, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë, subjektit "ELECTRAL" sh.p.k., me administrator Z. Redi Frashëri me këto të dhëna:

Koordinatat: X 4435689.8256; Y 4453368.4697; Z 530

Prurja mesatare : 2.2698 m3/sek

Prurja e llogaritur: 0.2014 m3/sek



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SEKRETARIATI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"

Prurja e ekologjike: 2.9 m3/sek

Fuqia e instaluar e hidrocentrali llogaritet të jetë **1874 KW**

Për përdorimin e këtij burimi uJOR duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËRGJEGJËS I A.B.U "VJOSË"

Ilir PROFKA

KRYETAR I K.B.U "VJOSË"

Flamur MAMAJ